

URDHËR
Nr. 1150, datë 31.12.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - b) zogjve 24-orësh;
 - c) mishit të freskët;
 - d) materialit biologjik të shpendëve të pa shoqëruar me test diagnostik PCR që vërteton mosprezencën e virusit;
 - e) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të Pseudopestit, ku përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2.5 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2.3 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës të tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;
 - dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:
 - 65°C në 39.8 sekonda;
 - 70 °C në 3.6 sekonda;
 - 74 °C në 0.5 sekonda;
 - 80°C në 0.03 sekonda;
 - f) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,
- nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2	Mazowieckie	Siedlce	Przesmyki*
3	Mazowieckie	Łosice	Łosice*
4	Podlaskie	Mońki	Mońki*
5	Podlaskie	Mońki	Goniadz*
6	Podlaskie	Mońki	Krypno (Trzcianne)*
7	Podlaskie	Sokółka	Janów*
8	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
9	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
10	Podlaskie	Siemiatycze	Drohiczyn*
11	Podlaskie	Białystok	Wasilków*
12	Podlaskie	Sokółka	Korycin*
13	Podlaskie	Sokółka	Suchowola*
14	Podlaskie	Białystok	Łapy*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve °C mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Urdhri nr. 1094, datë 19.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

